



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr. 01-060/01-0003472/26
Data 22.01.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punës së Kuvendit, si dhe në pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e kuvendit, znj. Adelina Spahiu:

T H È R R E T

Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj, e cila do të mbahet me datë 30.01.2026, (ditë e premte), me fillim prej orën 10:00, në Sallën e Kuvendit

Mbledhja do të ketë këtë:
REND DITE

1. Fjala hyrëse,
2. Miratimi i rendit të ditës,
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara,
4. Propozim-vendim për Formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), Komuna Skenderaj, (Raporton Kryetari i komunës **z.Sami Lushtaku**).
5. Propozim-vendim për Formimin e komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendës drejtor, Komuna Skenderaj, (Raporton Drejtori i DKA-së, **z.Kastriot Duraku**).
6. Shqyrtimi i Raportit të Punës së ekzekutivit të komunës së Skenderajt, për vitin 2025, (Raporton Kryetari i komunës **z.Sami Lushtaku**).
7. Shqyrtimi i Raportit Financiar të buxhetit të komunës së Skenderajt, janar-dhjetor 2025, (Raporton Drejtori i DBF-së, **z.Behxhet Maliqi**).
8. Propozim-vendim për miratimin e Raportit Përfundimtar Nr.09-052/01-0052869/25, i datës 18.12.2025, i hartuar nga komisioni komunal, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara kryesisht nga zjarret, era, breshëri, ngricat dhe fatkeqësitë tjera, për muajin Korrik-Dhjetor 2025, (Raporton Drejtori i DSHP, **z.Arber Geci**).
9. Propozim-vendim për Rishqyrtimin e Vendimit Nr.01-020/01-0000460/26, i datës 05.01.2026, për Formimin e Komitetit për Politikë e Financa (KPF), (Raporton Kryesuesja e kuvendit, **znj.Adelina Spahiu-Alija**).
10. Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme.

KRYESUESJA E KUVENDIT

Adelina Spahiu-Alija





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



KOMUNITETI E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / ASSEMBLY OF MUNICIPALITY / SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. 01-060/01-0003472/26
Data 22-09-2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës 30.12.2025, ora 10:00

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse.
2. Miratimi i rendit të ditës.
3. Shqyrtimi i dy procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
4. Propozim-vendim për formimin e Komitetit për Politik e Financa, Nr.01-020/01-0052694/25, i datës 17.12.2025, (Raporton Kryesuesja e Kuvendit, **znj. Adelina Spahiu-Alija**).
5. Propozim-vendim për formimin e Komitetit për Komunitete, me Nr.01-020/01-0052697/25, të datës 17.12.2025, (Raporton Kryesuesja e Kuvendit, **znj. Adelina Spahiu-Alija**).
6. Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Skenderajt për vitin 2026, me Nr.01-112/01-0052698/25, i datës 17.12.2025, (Raporton Kryesuesja e Kuvendit **znj. Adelina Spahiu-Alija**).
7. Plani i Punës së Ekzekutivit për vitin 2026, me Nr.02-112/01-0052640/25, i datës 17.12.2025, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Sami Lushtaku**).
8. Propozim-vendim për miratimin e vendimit mbi publikimin e Listës së pronave të paluajtshme të Komunës së Skenderajt për dhënien në shfrytëzime për vitin 2026, me Nr.02-463/01-0052710/25, i datës 17.12.2025, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Sami Lushtaku**);
9. Raporti i Planit vjetor të Integritetit të Komunës së Skenderajt për vitin 2025, me Nr.02-052/01-0052703/25, i datës 17.12.2025, (Raporton zyrtari **z. Mirsad Gashi**);
10. Shqyrtimi i Raportit të performances komunal për vitin 2025, me Nr.02-052/01-0052705/25, i datës, 17.12.2025, (Raporton zyrtari **z. Baki Beqiri**);
11. Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme.

Kryesuesja e kuvendit, Adelina Spahiu: I nderuar kryetari i komunës, z. Sami Lushtaku, nënkryetar i komunës z. Fadil Nura, të nderuar anëtar të kuvendit, dhe gjithë ju të pranishëm, në sallë janë 26 anëtar, bashkëngjitet mbledhjes Rrezarta Hasani-Ibrahimi.

-Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: Fjala përshëndetëse, kryesuese i kam një serë çështjesh, besoj që do duhej me i diskutua, E para punës ne jemi anëtar të kuvendit dhe është dashur me na thirrë për mbledhje me kohe, dhe mua askush nuk me ka thirr për mbledhjen e sotme, dhe është dashur dikën me thirr e me vetë se a është e vërtet që sot kemi mbledhje. Çështja tjetër, ti e dinë që me ligje je e obliguar me na ardhur materiali 7 dite në email para mbledhjes, në ndërkohë mua materiali me ka ardhur dje në email, edhe atë tu insistua të lutem dërgona materialin, dhe gjithashtu këshilltaret e ri do duhej me pas tash emailit e hapur. Gjithashtu është shume e rëndësishme që një pjesë e vendimeve që KPF-ja dhe Komiteti për komunitete, që fillimisht me u themelua këto komitete e me kalua në pjesët tjera si Planet e punës se kuvendit e te ekzekutivit sepse ashtu e kërkon ligji. Tash imagjino

jemi kuvend komunal dhe jemi anëtar të kuvendit, na propozohet neve plani i punës të kuvendit po pa qenë të përfshirë anëtarët e kuvendit, është një farë qasje tërësisht diktatoriale, ku kryesuesja e përcakton se çfarë këna me bë, dhe është kanë dashur me u mbledh grupi parlamentar i PDK-së, i LVV-së, dhe ti bien propozimet për KPF, dhe të kalojnë përmes KPF-së dhe kjo është në demokraci procedurë. Tash e keni planin e punës së ekzekutivit dhe nuk e dimë hala kush është drejtor dhe do duhej me qenë edhe ata të përfshihen idetë e tyre në planin e punës për me i diskutua. Dhe të ftojë me i respektua këto vendime, që janë tërësisht procedurale e ligjore sepse krejt kjo seancë nuk ka kuptim sepse është tërësisht në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret.

Kryesuesja; Hysni, sa i përket materialit, nuk e di qysh të ka ardhur ty dje, ku neve na ka ardhur para 7 dite materiali, dhe e kam si provë në email me ore me datë, dhe sa i përket anëtarëve të ri janë në procedure të hapjes së emailave, po sistemi nuk po i pranon pa emër të prindit dhe sot e keni listën me i shënua emra të prindërve anëtarët e ri, fjalën ja kaloj;

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura: Fjala përshëndetëse, urime për së cilin anëtar mandati i juaj, në aspektin teknik dërgimi i materialit është çështje e sekretarisë dhe duhet me pas parasysh se materiali duhet të dërgohet 7 dite para mbajtjes së mbledhjes. Trupat e kuvendit po i formojmë në këtë mbledhje, po planet e punës se kuvendit dhe te ekzekutivit i kemi shti për arsye të performances që është obligative që kërkohen me kalua këtë vite për vitin e ardhshëm.

Afrim Kabashi-NSD: Fjala përshëndetëse, urime për të gjithë ky mandatë, edhe unë kam dëgjuar në kafe për mbajtjen e mbledhjes se kuvendit, dhe emaili nuk me ka ardhur, dhe ne sekretari kam qenë me marr materialin fizikisht dhe nuk ma kanë dhen, dhe dua me dite me ligj a lejohet apo jo dhënia e materialit fizikisht? Dhe mua me ka thënë zyrtari Jeton Osmani që nuk jemi të obliguar me japë materialin fizikisht, dhe të thirret një mbledhje kaq e rëndësishme me këto pika e mos me kanë të përgatitur besoj që nuk është në rregull. Dhe kryesuese në mandatin e kaluar na ke ftua për konsultë grupet parlamentare dhe kësaj radhe nuk na ke ftua, dhe është kanë mirë me na ftua para se me u formua komitetet e përhershme.

Kryesuesja: Afrim, Jetoni ka vepruar drejt, me qenë se ne ju kemi pajisur me llaptop dhe vetëm anëtarët e ri kemi drejt me i pajisur me material fizikisht derisa ti pajisim me llaptop., Hysni nuk ki drejt replike,

Hysni Mehani-LVV: Kryesuese kam drejt replike ndaj z.Nura, qëndrimi i jonë është ky ne relacion me këtë që po thoni ju, ju e keni këtë të performances, po na jena tu fole për atë që ka rend e ligj dhe ka respektim të rregullores, pra rendi e ligji respektimi i rregulloreve e kërkon që na me vazhdua me fole për pjesën e kësaj, dhe sa i përket fyerjeve të z. Lushtaku nuk kam çka të them është çështje e tij.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet debati, shkojmë votim, Konstatojmë me (21) vota për, (5) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi ditës, me vërejtje.

Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,

-Shqyrtimi i dy procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara, e hapë debatin, nëse nuk ka, Konstatojmë me (21) vota për, (5) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e datës 25.09.2025, dhe me (21) vota për, (4) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e datës 04.12.2025.

Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës;

-Propozim-vendim për formimin e Komitetit për Politik e Financa, Nr.01-020/01-0052694/25, i datës 17.12.2025, (Raporton Kryesuesja e Kuvendit),

Adelina Spahiu-Alija: Propozohet të formohet Komiteti për Politikë e Financa, në përbërje prej 7 anëtarëve (që kryesohet nga Kryesuesja e Kuvendit). Komiteti për Politikë e Financa, kryesohet nga Kryesuesi i kuvendit të komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin

e etniteteve politike në kuvendin e komunës. Etniteti politik me numër me të madh të vendeve (ulëseve) varësisht nga përqindja e përfaqësimit në kuvend duhet të përfaqësohet edhe në komitet, vazhdon me etnitetin e dytë që ka numrin me të madh të anëtarëve të kuvendit e kështu me radhë deri sa të ndahen të gjitha vendet në komitet, në këtë komitet duhet të reflektojë barazia gjinore në pajtim me legjislacionin në fuqi. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Politikë e Financa është (4) vjeçar i njëjtë me anëtarët e Kuvendit. Anëtarët e Komitetit për Politikë e Financa nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtar të komiteteve tjera, fjalën ja kaloj një anëtar nga subjekti politik PDK, për propozime;

Alban Berisha-PDK: Fjala përshëndetëse, duke pas parasysh gjithherë konten gjinore propozimet nga radha e PDK, për anëtar të KPF-së, janë ex offico, Adelina Spahiu-Alija- kryesuesja,

- Aferdita Rama
- Fikret Rexhepi
- Dardan Shala, dhe
- Alban Berisha, faleminderit.

Kryesuesja; Vazhdojmë me subjektin e dytë LVV, ti jepe propozimin për anëtar të KPF, gjithmonë duke e respektuar konten gjinore, siç e bëri edhe subjekti i parë, dhe propozimi i subjektit të dytë të jetë i gjinisë femërorë, fjalën ja kaloj:

Nezir Bejta-LVV: Fjala përshëndetëse, grupi jonë parlamentar LVV, për anëtar të KPF-së , propozon:

- Hysni Mehani.

Kryesuesja; Vazhdojmë me subjektin e tret NSD, ti jepe propozimin për anëtar të KPF, fjalën ja kaloj:

Afrim Kabashi-NSD: Për anëtar të KPF, e propozoj veten,

- Afrim Kabashi.

Kryesuesja; A ka propozime tjera, nëse nuk ka, shkojmë në votim që propozimet të votohen pako apo një nga një, kush është që anëtarët të votohen një nga një, Konstatojmë me (21) vota për, (3) kundër dhe (0) abstenim, Propozimi për votim një nga një i merr votat e mjaftueshme, kush është që anëtarët e propozuar të votohen pako Konstatojmë me (3) vota për, (21) kundër dhe (1) abstenim, nuk kalon propozimi që anëtarët të votohen pako.

Vazhdojmë me votimin një nga një të anëtarëve për tu bërë pjesë e KPF-së,

Konstatojmë me (21) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, **Alban Berisha**, kalon:

Konstatojmë me (21) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, **Aferdita Rama**, kalon:

Konstatojmë me (21) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, **Fikret Rexhepi**, kalon:

Konstatojmë me (21) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, **Dardan Shala**, kalon:

Konstatojmë me (3) vota për, (21) kundër dhe (0) abstenim, **Hysni Mehani**, nuk kalon, dhe

Konstatojmë me (27) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, **Afrim Kabashi**, kalon:

Atëherë Hysni Mehani nuk i merr votat e mjaftueshme për me qenë pjesë e KPF-së, fjalën ja kaloj Hysni Mehanit për me dhënë një propozim për me respektua konten gjinore.

Hysni Mehanit-LVV: Respektoni ju konten gjinore së neve na vyen kota gjinore edhe për komitetin për komunitete që është po ashtu komitet i përhershëm. Krejt kjo salle e dinë që kjo nuk ka të bëjë me konten gjinore po e keni me mua personalisht, mos i përdorni konten gjinore dhe gratë për mem luftua mua, dhe mua kjo veç me bënë nderë, mos i përdorni gratë për luftë politike ndaj meje. Dhe propozimi i LVV për anëtar të KPF-së e ka dhënë profesorë Nezir Bejta.

Kryesuesja; Vazhdojmë me propozimin e subjektit të parë PDK, që propozimi të jetë i gjinisë femërorë, fjalën ja kaloj;

Alban Berisha-PDK: Për anëtar të KPF, propozoj;

- Donika Mustafa.

Kryesuesja: Shkojmë në votim që Donika Mustafa të behet anëtare e KPF-së, Konstatojmë me (21) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, Donika Mustafa, kalon dhe behet anëtare e KPF-së. Atëherë këta janë anëtarët e KPF;

- **Alban Berisha,**
- **Aferdita Rama,**
- **Fikret Rexhepi,**
- **Dardan Shala,**
- **Afrim Kabashi, dhe**
- **Donika Mustafa.**

Kush është që anëtarët në fjalë të jenë pjesë e KPF-së, Konstatojmë me (21) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet formimi i Komitetit për Politik e Financa, me Nr.01-020/01-0052694/25, i datës 17.12.2025, me anëtarët si me lartë.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit të ditës,

Propozim-vendim për formimin e Komitetit për Komunitete, me Nr.01-020/01-0052697/25, të datës 17.12.2025, (Raporton Kryesuesja e Kuvendit),

Adelina Spahiu-Alija; Komiteti për Komunitete përbëhet nga anëtarët e kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesve të komuniteteve, Komiteti për Komunitete përbëhet nga së paku një përfaqësues i komunitetit jo shumicë që jetojnë në komunë, Përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit të komuniteteve i cili komitet duhet të reflektojë barazia gjinore në pajtim me legjislacionin në fuqi. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Komunitete është (4) vjeçar i njëjtë me anëtarët e Kuvendit. Anëtarët e Komitetit për Komunitete nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtar të komiteteve tjera. Nga kuvendi duhen të jenë dy anëtar, dhe nga Zyra për kthim na ka dërgua propozimet e tyre, si në vijim:

- Dejan Shapiq - Përfaqësuese nga komuniteti Serbë, Bajë,
- Gordana Tomiq - Përfaqësuese nga komuniteti i të kthyerve,
- Fatjona Tomasheviq - Përfaqësuese nga komuniteti Serbe, Syrigan ,
- Miftar Salihu - Përfaqësuese nga komuniteti Ashkali,
- Albina Arifi - Përfaqësuese nga komuniteti Boshnjak,

Kërko nga subjekti i parë të jep një propozim për Komitetin për komunitete, fjalën ja kaloj;

Alban Berisha-PDK: Nga PDK-ja për anëtar të Komitetit për komunitete propozoj:

- Kushtrim Dragaj.

Kryesuesja: Kërkojë një propozim nga subjektet politike që nuk janë përfshi në komitete, fjalën ja kaloj;

Nezir Bejta-LVV: Për anëtar të Komitetit për komunitete propozoj nga LVV;

- Floriana Halili.

Kryesuesja; A ka propozime nga subjektet tjera, fjalën ja kaloj;

Feriz Shala-AAK: Për anëtar të Komitetit për Komunitete nga IQ, propozoj;

- Hisni Avdullahi.

Kryesuesja: A ka propozime tjera, me qenë se nuk ka, e kemi për detyrë me shkua në votim një nga një se janë tri propozime.

Konstatojmë me (22) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, Kushtrim Dragaj, kalon,

Konstatojmë me (4) vota për, (20) kundër dhe (2) abstenim, Floriana Halili, nuk kalon, dhe

Konstatojmë me (22) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim, Hisni Avdullahi, kalon,

Shkojmë në votim si pako, Konstatojmë me (21) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, Formohet Komiteti për komunitete me Nr.01-020/01-0052697/25, të datës 17.12.2025, me këtë përbërje, si në vijim:

- **Dejan Shapiq** - Përfaqësuese nga komuniteti Serbë, Bajë,
- **Gordana Tomiq** - Përfaqësuese nga komuniteti i të kthyerve,
- **Fatjona Tomasheviq** - Përfaqësuese nga komuniteti Serbe, Syrigan ,
- **Miftar Salihu** - Përfaqësuese nga komuniteti Ashkali,
- **Albina Arifi** - Përfaqësuese nga komuniteti Boshnjak,
- **Kushtrim Dragaj** - Përfaqësuese nga legjislativi, PDK dhe
- **Hisni Avdullahi** - Përfaqësuese nga legjislativi, IQ.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit ditës;

-Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Skenderajt për vitin 2026, me Nr.01-112/01-0052698/25, i datës 17.12.2025, (Raporton Kryesuesja e Kuvendit);

Adelina Spahiu-Alija; Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët, dhe funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore. Me planin e punës janë paraparë 11 seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca tjera përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme, solemne dhe urgjente sipas nevojës, siç parashihet me LVL dhe Statutin e Komunës. E hapë debatin, nëse nuk ka, shkojmë në votim;

Konstatojmë me (21) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, Miratohet Plani i punës së Kuvendit për vitin 2026.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit ditës;

-Plani i Punës së Ekzekutivit për vitin 2026, me Nr.02-112/01-0052640/25, i datës 17.12.2025, (Raporton në vend të Kryetarit, nënkryetari i komunës).

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura: Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2026, me kohe e keni marrë materialin, ky planë paraqet kornizat, angazhimet për vitin 2026 të ekzekutivit, që janë të përcaktuara punët e drejtorive zyrave sektorëve, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: E hapë debatin, nëse nuk ka, Konstatojmë me (21) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, Miratohet Plani i punës së ekzekutivit për vitin 2026.

Vazhdojmë me piken 8 të rendit ditës.

-Propozim-vendim për miratimin e vendimit mbi publikimin e Listës së pronave të paluajtshme të Komunës së Skenderajt për dhënien në shfrytëzime për vitin 2026, me Nr.02-463/01-0052710/25, i datës 17.12.2025, (Raporton në vend të Kryetarit, nënkryetari i komunës).

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura: Propozim-vendim për miratimin e vendimit mbi publikimin e Listës së pronave të paluajtshme të Komunës së Skenderajt për dhënien në shfrytëzime për vitin 2026, edhe kjo pike ligji e parasheh obligim ligjor që në fund të vitit me u miratua që këto prona që planifikohen me u dhënë në shfrytëzim për vitin 2026, ju ftoj për miratoni.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-LVV: Jemi të pa përgatitë për shkak të vonesës së materialit, dhe nuk i dimë parcelat dhe vota jonë është kundër, për shkak se nuk i dimë cilat parcela janë dhe ku ndodhen, dhe do duhej me qenë drejtori me i specifikua se ku ndodhen këto parcela përmes projektorit. Po ajo çka po me intereson janë shume prona neper shume fshatra dhe parcela shitesë dhe nuk po specifikohet qëllimi për çka me u jep.

Afrim Kabashi-NSD: Nënkryetare besoj që kjo pikë do duhej me ardh në seancën tjetër sepse nuk jemi të përgatitur, dhe me na specifikua në detaj përmes projektorit për së cilën pronë së ku gjendet.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura: Nuk kam mendua me lanë për seancën tjetër këtë pik për arsye ligjore, së ligji e parasheh deri në fund të vitit me nxjerr këtë vendim dhe me publikua në faqe të komunës, dhe ju e dini çdo vite e kemi nxjerr kështu në fund të vitit, dhe është kriter ligjor. Dhe çdo njeri ka drejt qasje në dokumente zyrtare me shikua çdo parcelë ku ndodhet. Dhe shumica janë parcela të njëjta me vitin e kaluar në këtë listë.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: Nuk mora përgjigje, perse janë pjesë e parcelave shtesë që figurojnë neper fshatar. Dhe z. Nura tha janë parcela të njëjta me vitin e paraprak, së i bie, as ju nuk e dini cilat parcela janë dhe ke prua diçka së nuk e dinë së çka po votohet dhe na krejt se dimë çka po votohet.

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura: Unë nuk i di ku ndodhen këto prona përmendsh, këto janë prona komunale dhe është parakushte me qenë në këtë listë, është kriter ligjor, dhe çdo pronë kur hynë në procedurë për dhënie në shfrytëzime ka me qenë interesi publik dhe baza ligjore për me marr miratimin.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Nezir Bejta-LVV: Nënkryetarë prej 4 dhjetorit deri sot, është afër një muaj dhe nëse kjo çështje e këtyre pronave është kaq e ndejshme përse e keni lanë për fund, perse po na qitni para aktit të kryer, kur nuk dimë çka me votua.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Nënkryetari i komunës, Fadil Nura: Profesor e kemi obligim ligjor, është seanca e fundit për këtë vite që duhet me miratua këtë vendim për liste të pronave për vitin 2026, deri me 31 dhjetor dhe na jemi në rregull me ligjin dhe me ministrin kemi pas komunikime dhe na ka rekomandua me vazhdua me këtë vendim për prona qysh e parasheh ligji.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, Konstatojmë me (21) vota për, (2) kundër dhe (0) abstenim miratohet Propozim-vendim për miratimin e vendimit mbi publikimin e Listës së pronave të paluajtshme të Komunës së Skenderajt për dhënien në shfrytëzime për vitin 2026.

Vazhdojmë me piken 9 të rendit të ditës;

-Raporti i Planit vjetor të Integritetit të Komunës së Skenderajt për vitin 2025, me Nr.02-052/01-0052703/25, i datës 17.12.2025, (Raporton zyrtari)

Mirsad Gashi: Fjala përshëndetëse, komuna e Skenderajt qysh në seancën e tetorit 2024 e ka hartuar dhe e ka miratuar ky kuvend Planin e integritetit, është një dokument që e kemi obligim ligjorë për parandalimin e korrupsionit, po ashtu e kemi obligim edhe nga MAPL-ja dhe po ashtu është indikator i matjes së performancës, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Afrim Kabashi-NSD: Mirsad a janë të nënshkruar deklaratat e kodit të etikës?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Mirsad Gashi: I nderuar deklaratat e kodit të etikës janë të nënshkruar dhe ka qenë obligim nga kodi i etikës dhe një pjesë e juaj nuk e keni nënshkruar dhe njëkohësisht e keni miratuar një komision për zbatim të kodit dhe nuk keni kërkuar llogari kurrë.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: Ti ishte këtu gjatë seancës apo, edhe e pe fjalorin e z.Lushtaku ndaj meje, cilat janë masat e juaja për këto raste?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Mirsad Gashi: Hysni, nuk isha ne sallë, tash erdha, nuk e di për çka e ke fjalën, po edhe nëse ka pas diçka, unë nuk jam kryetar i komisionit për zbatimin e kodit të etikes.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, Konstatohet me (21) vota për, (3) kundër dhe (0) abstenim, përkrahet Raporti i Planit vjetor të Integritetit të Komunës së Skenderajt për vitin 2025.

Vazhdojmë me pikën 10 të rendit të ditës;

-Shqyrtimi i Raportit të performances komunal për vitin 2025, me Nr.02-052/01-0052705/25, i datës, 17.12.2025, (Raporton zyrtari);

Baki Beqiri: Fjala përshëndetëse, me datë 17 tetor 2025 kemi pranuar konfirmimin për publikimin e raportit të performances për vitin 2024, krahas raportit të përgjithshëm të komunës janë publikuar edhe raportet individuale për se cilën komunë, komuna jonë është renditur në vendin e dytë me 82.85 pikë, që janë të dhëna zyrtare të publikuara.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Afrim Kabashi-NSD: Urime për performancën, po performancë a është ajo që kemi kërkuar disa herë, për pajisjet elektronike për zërimin e seancave, transmetimin live, dhe kamerat, a hinë në kuadër të performances kjo?

Kryesuesja: Afrim, zërimi është në kuvend, seanca live është tu u transmetua, kamerat i kemi vendos, veç jemi duke pritë me gjete një monitorues për kamera, dikush tjetër, nëse nuk ka, Konstatohet me (21) vota për, (3) kundër dhe (0) abstenim, përkrahet Shqyrtimi i Raportit të performances komunal për vitin 2025, me Nr.02-052/01-0052705/25, i datës, 17.12.2025.

Vazhdojmë me pikën 11, nuk kemi pyetje për këtë mbledhje, mirupafshim.

Procesmbajtësi

Kryesuesja e Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opstina Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13, nenit 58 shkronja a), shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 50 shkronja a) dhe shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01/110-385 të datës 03.12.2008, ndërlidhur me nenin 3, nenin 4, nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB dhe UA 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kryetari i Komunës së Skenderajt z.Sami Lushtaku i propozon Kuvendit që në mbledhjen e rregullt të datës 30.01.2026 të miratojë këtë:

PROPOZIM

I. Për miratimin e vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, pranë Komunës së Skenderajt, në këtë përbërje:

1. Sami Lushtaku, Kryetar i Komunës - Kryesues i KKSB-së;
2. _____, Komandant i Stacionit të Policisë në Skenderaj - anëtar;
3. _____, Përfaqësues Legjitim i secilës bashkësi fetare të Komunës - anëtar;
4. _____, Përfaqësues i secilit Komitet Etnik të komunës, anëtar;
5. _____, Kryesues i Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës – anëtar;
6. _____, Zyrtar/e për Barazi Gjinore, anëtar;
7. _____, Drejtor i DKA - anëtar;
8. _____, Kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës;
9. _____, Përfaqësues i FSK-së, anëtar;
10. _____, Përfaqësues i secilit Këshill Lokal për Siguri Publike, anëtar;
11. _____, Kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi;
12. _____, Përfaqësues i Sektorit të Emergjencave Civile Komunale, anëtar;
13. _____, Përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtar;
14. _____, Përfaqësues i OJQ, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara, anëtar;

II. Objektivat, detyrat, përgjegjësitë dhe funksionimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si dhe të drejtat dhe obligimet e anëtarëve në mënyrë të detajuar janë të përcaktuara me nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për KKSB nr.27/2012 të MPB dhe 03/2012 të MAPL-së.

- III. KKSBB-ja është organ këshillues për çështje të Sigurisë në Bashkësi, me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve, bashkësive etnike, fetare, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe përfaqësimi i barazisë gjinore.
- IV. Mandati i anëtarëve të KKSBB-së është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendi Komunal.
- V. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së

Kryetari i Komunes

Sami Lushtaku





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SHUPËT NA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 07-020/01-0001755/26
Data.
Data. 12. 01. 2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Arsim / Department of Education

DATE/A:	12.01.2026
PËR/ZA/TO:	Kuvendin Komunal të Skenderajt
NGA/OD/FROM:	Kastriot Duraku – Drejtor i DKA-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim – Vendim për formimin e komisionit përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendës drejtor

Në mbështetje të nenit 62, paragrafi 62.3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 14 paragrafi 8 e nenparagrafi 8.1, 8.2 dhe 8.3 të Rregullorës (QRK) nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, Drejtoria Komunale e Arsimit bën këtë:

PROPOZIM

Miratimin e propozim - vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendës drejtorë për shkollat e komunës së Skenderajt

Bazuar në nenin 14 paragrafi 8 e nenparagrafi 8.1, 8.2 dhe 8.3 të Rregullorës (QRK) nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, Drejtoria Komunale e Arsimit, propozon këta anëtarë të komisionit:

- DKA – Shkëndije Idrizi
- Përfaqësues i Këshillit të Prindërve në nivel komunal, më ekspertizë në fushën e arsimit - Avdi Jakupi
- Përfaqësues i MASHTI -

Shtojcë: Bashkangjitur këtij propozimi, gjeni nenin 14 paragrafi 8 e nenparagrafi 8.1, 8.2 dhe 8.3 të Rregullorës (QRK) nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar.

6. Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar me këtë nen, dorëzohet kopje fizike në zyrën dhe afatin e përcaktuar me konkurs publik, si dhe në kopje elektronike nëse është e përcaktuar.
7. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Neni 14 Përbërja e komisionit përzgjedhës

1. Procesi i përzgjedhjes së personelit edukativo-arsimor koordinohet dhe drejtohet nga NjMBNj e punëdhënësit në bashkëpunim me DKA në nivel komune.
2. DKA në nivel komune në afat prej 3 ditësh nga dita e përfundimit të shpalljes së konkursit, nxjerr vendim për themelimin e Komisionit përzgjedhës, përfshirë edhe kryetarin/en e komisionit, i cili duhet të jetë nga drejtoria komunale e arsimit.
3. Në rastin e Qendrave Burimore, komisioni themelohet me vendim të Sekretarit/es së MASHTI.
4. Në rastin e AAAPARr, komisioni themelohet me vendim të drejtorit/es së AAAPARr.
5. Komisioni përzgjedhës themelohet për çdo grup pozitash apo pozitë për të cilën zhvillohet konkurrimi.
6. Në procedurën e emërimit të Komisionit, DKA, MASHTI dhe AAAPARr shqyrtojnë nëse ndonjëri nga anëtarët e propozuar të komisionit ka një konflikt interesi sipas legjislacionit në fuqi me kandidatët/et që kanë konkurruar në pozitën/at e tilla.
 - 6.1. Në një rast të tillë, DKA, MASHTI, AAAPARr, është e detyruar sipas detyrës zyrtare të eliminojë konfliktin e interesit duke e ndërruar sipas së njëjtës procedurë anëtarin/en që ka një status të tillë papajtueshmërie.
 - 6.2. Pavarësisht vlerësimit nga DKA, MASHTI, AAAPARr, anëtarët e përzgjedhur në Komision duhet të vetëdeklarohen, përmes nënshkrimit të një dokumenti formular, nëse ata kanë ndonjë situatë papajtueshmërie me kandidatët që kanë konkurruar në konkursin që ata do e vlerësojnë.
7. Komisioni përzgjedhës është ad hoc. Mandati i tij përfundon me nxjerrjen e vendimit/eve përfundimtar/e për përzgjedhjen e kandidatit/ëve në pozitën/at e kërkuara me konkurs.
8. Komisioni përzgjedhës për institucionet arsimore obligohet të ketë përfaqësim gjinor që janë në varësi të komunës dhe ka këtë përbërje:
 - 8.1. Dy anëtarë të komunës të cilët propozohen nga DKA dhe miratohen nga Kuvendi Komunal. Anëtari i parë është i punësuar në DKA, ndërsa anëtari i dytë i propozuar nga DKA mund të jetë: ekspert i pavarur i arsimit, drejtor/e i institucionit arsimor me performancë të lartë, përfaqësues nga këshilli i prindërve në nivel komune me kualifikim dhe ekspertizë në fushën e arsimit. Anëtari i komisionit i punësuar në DKA, njëherit është edhe kryetar/e i/e komisionit;
 - 8.2. Një anëtar/e nga MASHTI, i cili përcaktohet nga MASHTI, pasi që ka marrë njoftim zyrtar, email zyrtar nga DKA;

8.3. Dy përfaqësues të Këshillit drejtues nga IEAA-AP, në cilësinë e vëzhguesve, një prind dhe një mësimdhënës.

9. Komisioni përzgjedhës për Qendrat Burimore ka këtë përbërje:

9.1. Një (1) anëtar/e nga MASHTI (kryetar i komisionit);

9.2. Një (1) anëtar/e nga Qendra Burimore për të cilën organizohet konkursi;

9.3. Një (1) anëtar/e nga Këshilli i Prindërve të Qendrës Burimore përkatëse;

9.4. Dy përfaqësues të Këshillit drejtues të Qendrës Burimore, në cilësinë e vëzhguesve.

10. Komisioni përzgjedhës për Qendrat e Kompetencës ka këtë përbërje:

10.1. Një (1) anëtar/e nga AAAPARr (kryetar i komisionit);

10.2. Një (1) anëtar/e nga Qendra e Kompetencës për të cilën organizohet konkursi;

10.3. Një (1) anëtar/e nga Këshilli i Prindërve të Qendrës përkatëse të Kompetencës.

10.4. Dy përfaqësues të Këshillit Drejtues të Qendrës së Kompetencës, në cilësinë e vëzhguesve.

11. Anëtarët e komisionit nga MASHTI dhe DKA duhet të kenë së paku një kualifikim të barasvlefshëm me kërkesat për kualifikim të kandidatëve për pozitë të drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës.

12. Asnjë nga anëtarët e komisionit përzgjedhës nuk mund të jenë persona që janë të angazhuar politikisht apo që kanë një pozitë udhëheqëse partiake, dhe duhet të kenë të dëshmuar pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre partiake e politike.

13. Për të mbështetur punën e Komisionit përzgjedhës, MASHTI përgatitë Udhëzues të veçantë për administrimin dhe dokumentimin e procedurës së përzgjedhjes brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.

Neni 15

Përzgjedhja e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës në IAAP

1. Zyrtari më i lartë administrativ i komunës, në bazë të rezultateve të vlerësimit nga komisioni, sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, i ofron kontratë kandidatit/es të/së përzgjedhur për drejtor/eshë dhe zëvendësdrejtor/eshë të/së IEAA-AP.

2. Sekretari/ja i/e MASHTI-t, në bazë të rezultateve të vlerësimit nga komisioni, sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, i ofron kontratë kandidatit/es të/së përzgjedhur për drejtor/eshë dhe zëvendësdrejtor/eshë të/së Qendrës Burimore.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ



Nr. 02-052/01-0003486/26
Data 22.01.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

RAPORTI I PUNËS SË EKZEKUTIVIT PËR VITIN 2025

Skenderaj, Janar 2026

Përmbajtja:

Raporti i Ekzekutivit për vitin 2025.....	3
Zyra për Informim	4
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJMBNJ)	6
Njësia e Auditimit të Brendshëm.....	8
Zyra Ligjore	9
Drejtoria për Administratë.....	10
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	13
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm (DZHENIT)	17
Drejtoria e Prokurimit	20
Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural	24
Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë	27
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	29
Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.....	31
Drejtoria për Shërbime Publike	34
Drejtoria e Inspekcionit	39
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Komuna e Skenderajt.....	46
Drejtoria Komunale e Arsimit- DKA	51

Raporti i Ekzekutivit për vitin 2025

Raporti i Ekzekutivit të Komunës së Skenderajt për vitin 2025 paraqet një pasqyrë të plotë të punës, aktiviteteve dhe rezultateve të arritura nga Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë Komunale gjatë këtij viti. Ky raport është hartuar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, aktet nënligjore në fuqi, si dhe obligimet që rrjedhin nga parimet e transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë.

Gjatë vitit 2025, Ekzekutivi Komunal ka qenë i përkushtuar në zbatimin e politikave zhvillimore, realizimin e projekteve kapitale dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët, duke pasur gjithmonë në fokus përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunës.

Aktivitetet e ndërmarra janë orientuar drejt përmbushjes së objektivave strategjike të planifikuara në dokumentet komunale, si dhe adresimit të nevojave dhe kërkesave të qytetarëve.

Raporti pasqyron punën e secilës drejtori komunale, duke evidentuar arritjet kryesore, sfidat e hasura dhe masat e ndërmarra për tejkalimin e tyre. Po ashtu, në këtë dokument paraqitet niveli i realizimit të planit të punës dhe shfrytëzimit të buxhetit, si dhe kontributi i Ekzekutivit në rritjen e transparencës dhe bashkëpunimit me Asamblenë Komunale, shoqërinë civile dhe partnerët institucionalë.

Ky raport i paraqitet Asamblesë Komunale dhe publikut si një mjet informues dhe llogaridhënës, me qëllim të forcimit të besimit të qytetarëve në institucionet lokale dhe avancimit të mëtejshëm të qeverisjes lokale në Komunën e Skenderajt.

Zyra për Informim

Në përputhje me kompetencat, përgjegjësitë ligjore dhe detyrat funksionale që i takojnë, Zyra për Informim gjatë gjithë vitit 2025 ka zhvilluar një aktivitet intensiv, të strukturuar dhe të vazhdueshëm në funksion të informimit të qytetarëve dhe publikut të gjerë lidhur me punën, projektet dhe veprimtaritë e Komunës së Skenderajt, duke synuar rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe komunikimit institucional.

Gjatë vitit raportues, Zyra për Informim ka realizuar publikimin e rregullt dhe sistematik të lajmeve ditore, njoftimeve zyrtare dhe informatave të tjera në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Skenderajt, duke mbuluar një gamë të gjerë aktiviteteve që lidhen me punën e organeve komunale. Janë publikuar me qindra shpallje publike, konkurse për punësim, thirrje për aplikime, njoftime për qytetarë, si dhe informata të tjera me interes të përgjithshëm. Po ashtu, janë bërë publike plane strategjike, raporte të punës, dokumente planifikuese, vendime të Kryetarit dhe Kuvendit Komunal, rregullore komunale, akte administrative dhe dokumente të ndryshme që burojnë nga veprimtaria e drejtorive komunale.

Një arritje e rëndësishme gjatë vitit 2025 ka qenë krijimi, lansimi dhe funksionalizimi i ueb-faqes së re zyrtare të Komunës së Skenderajt, në bashkëpunim me ASHI-në, e cila ka shënuar një avancim të dukshëm në fushën e informimit publik dhe transparencës institucionale të komunës sonë. Ueb-faqja e re është ndërtuar mbi standarde më të avancuara teknike dhe vizuale, duke ofruar stabilitet më të madh funksional, qasje më të lehtë për qytetarët, strukturë më të qartë të informacionit dhe mundësi më të shpejtë për publikimin e dokumenteve dhe njoftimeve zyrtare. Kjo ka mundësuar tejkalimin e vështirësive teknike të viteve të mëparshme dhe ka përmirësuar ndjeshëm efikasitetin e punës së Zyrës për Informim.

Në kuadër të rritjes së transparencës në fushën e prokurimit publik, Zyra për Informim ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me Zyrën e Prokurimit, duke publikuar rregullisht në ueb-faqen zyrtare të komunës të gjitha njoftimet dhe dokumentet që lidhen me aktivitetet e prokurimit, përfshirë njoftimet për kontrata, njoftimet për dhënie të kontratave, njoftimet për nënshkrimin e kontratave, vendimet për anulimin e procedurave të prokurimit, si dhe vendimet e Organit Shqyrtues të

Prokurimit (OSHP). Të gjitha këto informata janë bërë të qasshme për publikun në mënyrë të vazhdueshme dhe transparente.

Zyra për Informim ka qenë aktive edhe në rrjetet sociale, në veçanti në faqen zyrtare të Komunës së Skenderajt në rrjetin social Facebook, ku janë publikuar vazhdimisht informata, aktivitete, projekte infrastrukturore, takime zyrtare, vizita në terren dhe iniciativa të ndryshme me interes publik. Këto publikime kanë shërbyer si mjet shtesë komunikimi me qytetarët, duke siguruar informim të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë. Paralelisht, Zyra ka publikuar në platformën qendrore për konsultime publike draft-rregullore dhe dokumente të tjera që janë nxjerrë për konsultim publik, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe palëve të interesuara në proceset vendimmarrëse komunale.

Gjatë vitit 2025, Zyra për Informim, e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës, ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme dhe të drejtpërdrejtë të gjitha mbledhjet e Kuvendit Komunal, ndërsa pas përfundimit të tyre, publiku është informuar për mbarëvajtjen e seancave dhe vendimet e miratuara. Po ashtu, Zyra ka përcjellë nga afër edhe mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, si dhe takime të tjera të rëndësishme institucionale.

Zyra për Informim ka qenë në komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me Kabinetin e Kryetarit të Komunës, duke përcjellë në mënyrë të drejtpërdrejtë punën, angazhimet dhe aktivitetet ditore të Kryetarit. Janë ndjekur vizitat në terren, takimet zyrtare, diskutimet publike, takimet me qytetarë, debatet publike për draft-rregulloret komunale, diskutimet lidhur me buxhetin vjetor dhe planifikimet buxhetore afatmesme, si dhe aktivitetet e tjera të shumta të zhvilluara në kuadër të drejtorive komunale. Po ashtu, gjatë vitit janë ndjekur takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, takimet e Bordit të Drejtorëve dhe aktivitetet e tjera ndërsektoriale.

Gjatë vitit 2025, Zyra për Informim ka bashkëpunuar në mënyrë aktive dhe konstruktive me media të shkruara dhe elektronike, si dhe me organizata të shoqërisë civile, duke u ofruar informata të sakta, të plota dhe në kohë lidhur me veprimtarinë e Komunës së Skenderajt. Zyra ka qenë gjithmonë në dispozicion për sqarime dhe informata shtesë, duke kontribuar në raportim korrekt dhe objektiv për çështjet komunale.

Një pjesë e rëndësishme e punës së Zyrës për Informim gjatë vitit 2025 ka qenë edhe trajtimi i kërkesave për qasje në dokumente publike. Zyra ka vepruar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, duke pranuar, shqyrtuar dhe trajtuar me përgjegjësi të gjitha kërkesat.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJMBNJ)

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka zhvilluar dhe realizuar me sukses një sërë aktivitete dhe detyrash funksionale, të cilat kanë kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit administrativ, përmirësimin e proceseve të brendshme dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve njerëzore në Komunën e Skenderajt.

Të gjitha aktivitetet janë realizuar në përputhje të plotë me Planin Vjetor të Punës së NJMBNJ-së, si dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, aktet nënligjore dhe udhëzimet administrative përkatëse.

Ristrukturimi i pozicioneve brenda institucionit

Procesi i ristrukturimit është zhvilluar bazuar në analizën e nevojave organizative, respektimin e standardeve ligjore dhe planifikimin strategjik institucional. Ky ristrukturim ka përmirësuar organizimin e brendshëm, ka qartësuar përgjegjësitë dhe ka rritur efikasitetin në kryerjen e detyrave zyrtare.

Menaxhimi i pushimeve dhe dokumentacionit personal

NJMBNJ ka siguruar një qasje të rregullt, transparente dhe të barabartë në menaxhimin e pushimeve vjetore për të gjithë zyrtarët. Të gjitha procedurat janë realizuar përmes sistemit elektronik përkatës, duke mundësuar regjistrimin, aprovimin dhe monitorimin e saktë të ditëve të pushimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Janë sistemuar, verifikuar dhe përditësuar të gjitha dosjet personale të zyrtarëve në përputhje me standardet arkivore dhe kërkesat ligjore për menaxhimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke garantuar ruajtjen e dokumentacionit në mënyrë të sigurt, të saktë dhe të qasshme.

Po ashtu, janë kryer korrigjime, azhurnime dhe verifikime të vazhdueshme të të dhënave të stafit në sistemin SIMBNJ, duke siguruar që informacionet të jenë të plota, të sakta dhe të harmonizuara me gjendjen faktike të personelit të Administratës së Komunës së Skenderajt. Vlerësimi i

rezultateve të punës është realizuar përmes sistemit SIMBNJ, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara.

Aktivitetet kryesore gjatë vitit 2025:

- Mbështetje e vazhdueshme për zyrtarët në çështje administrative, procedurale dhe marrëdhëniet e punës.
- Përgatitja dhe dorëzimi i raporteve periodike dhe statistikore të kërkuara nga Ministria për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (DMZP) dhe Kryetari i Komunës.
- Kontribut në zhvillimin profesional të stafit përmes koordinimit, organizimit dhe ndjekjes së trajnimeve të ndryshme.
- Zbatimi i rregullt i ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe akteve nënligjore që lidhen me fushën e burimeve njerëzore.

Struktura e stafit gjatë vitit 2025:

- Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Administratën e Komunës dhe në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare: 47
- Numri i grave të punësuar: 24
- Numri i zyrtarëve të lartë udhëheqës: 24
- Numri i grave në pozita të larta udhëheqëse: 4
- Numri i grave nga komunitetet jo-shumicë në pozita udhëheqëse: 0
- Numri i zyrtarëve të emëruar në poste politike në komunë: 19
- Numri i grave të emëruara në poste politike: 5
- Numri i personave me nevoja të veçanta të punësuar: 2 (1 në Administratë, 1 në QKMF)
- Numri i grave me nevoja të veçanta: 1
- Numri i punonjësve nga komunitetet jo-shumicë: 0
- Numri i grave të punësuar nga komunitetet jo-shumicë: 0

NJMBNJ nuk ka pranuar asnjë kërkesë apo njoftim lidhur me zyrtarë të akuzuar nga organet e drejtësisë, dhe nuk është evidentuar asnjë rast pezullimi nga detyra i zyrtarëve komunalë për shkak të procedurave gjyqësore.

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (Njab) funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit, roli i saj është ofrimi i këshillëdhënës tek drejtoritë dhe zyrtaret e OB dhe i raporton direkt Kryetarit.

Gjatë vitit 2025 Njab ka realizuar aktivitetin e saj sipas legjislacionit në fuqi dhe ka raportuar tek Departamenti i Njesisë Qendrore Harmonizuese (NjQH), Ministria e Financave.

Raporti vjetor 2025 i Njab						
Gjithsej numri i auditimeve të planifikuara me plan vjetor sipas periudhave raportuese dhe realizimi i tij (për të cilat janë përpiluar raportet finale)						
Periudha raportuese	Numri i auditimeve të planifikuara	Ditët e planifikuara për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të planifikuar për angazhim	Numri i auditimeve të kryera	Koha e shpenzuar për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të angazhuar për auditim
Gjashtëmuji I	2	110	3	2	85	3
Gjashtëmuji II	3	125	3	3	113	2
Auditime me kërkesë	1	33	2	2	31	2
Gjithsejtë Vjetore	6	268	3	7	229	3
Arsyet për mos kryerjen e auditimeve sipas numrit të planifikuar – theksoni arsyet:						
Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik i dërgohen raportet finale të auditimit menjëherë pas kryerjes së auditimit						PO JO
Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik përpilon dhe vendos për planin e veprimit i cili përfshinë rekomandimet e pranuar dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren në pajtim me ligjin për KBFP						PO JO
Për rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit njësia për auditimit të brendshëm ka bazën e organizuar të dhënave për zbatimin e rekomandimeve						PO JO

Rekomandimet e dhëna përcjellën sipas planit të veprimit, ashtu sikur është përcaktuar me doracak të auditimit të brendshëm	PO	JO
Numri i rekomandimeve në raportet e auditimit/planet e veprimit dhe numri i rekomandimeve të zbatuara në periudhën raportuese:		
Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit:	10	
Numri i rekomandimeve të zbatuara:	5	
Numri i rekomandimeve në proces:	4	
Numri i rekomandimeve të pazbatuara:	1	

Zyra Ligjore

Zyra Ligjore e Komunës së Skenderajt, gjatë vitit 2025, ka ushtruar me përkushtim dhe efikasitet kompetencat e saj ligjore në funksion të mbështetjes së organeve komunale dhe garantimit të ligjshmërisë në procesin e vendimmarrjes. Gjatë këtij viti raportues, Zyra Ligjore ka përgatitur, shqyrtuar dhe trajtuar gjithsej **639 vendime**, duke kontribuar drejtpërdrejt në funksionimin e rregullt institucional, respektimin e legjislacionit në fuqi dhe mbrojtjen e interesit publik të Komunës së Skenderajt.

Në kuadër të aktiviteteve të saj, Zyra Ligjore ka realizuar këto veprime dhe akte juridike:

Vendime: 639
Propozime: 10
Kërkesa: 5
Përgjigje në kërkesa: 22
Autorizime: 24
Cedime: 47
Letra përkrahëse: 2
Vërtetime: 2
Konfirmime: 1
Njoftime: 1
Shkresa njoftuese: 2
Letra përcjellëse: 2
Urdhëresa: 1
Marrëveshje: 8

Drejtoria për Administratë

Drejtoria për Administratë ka qenë e angazhuar në ofrimin e shërbimeve transparente, cilësore dhe të shpejta, përmes avancimit të sistemeve elektronike, në shërbim të qytetarëve, bizneseve dhe ministrive të linjës.

1. Sektori i Gjendjes Civile

Gjatë vitit 2025, Sektori i Gjendjes Civile ka funksionuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet e MPB-së dhe ARC-së, duke përdorur sistemin elektronik në Zyrën Qendrore në Skenderaj dhe 6 zyra të vendit. Janë kryer të gjitha shërbimet e gjendjes civile, përfshirë regjistrimin e lindjeve, martesave dhe vdekjeve, si dhe lëshimin e dokumenteve përkatëse. Përmes E-Kioskës, qytetarët kanë marrë 168 dokumente personale gjatë vitit 2025.

Tabela me dokumentet e lëshuara nga zyrat e gjendjes civile

	Komuna	Certifikatë e lindjes	Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile	Certifikatë e shtetësisë	Certifikatë e martesës	Certifikatë e vdekjes	Certifikatë e vendbanimit	Certifikatë e gjendjes martesore	Deklaratë e bashkësisë familjare	Vërtetim nga arkivi	Totali
I	Skenderaj	2023	13904	41	3333	2034	935	918	4814	292	28294
	TOTALI	2023	13904	41	3333	2034	935	918	4814	292	28294

Tabela me dokumentet e lëshuara nga zyrat e gjendjes civile

	Komuna	Certifikatë e lindjes	Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile	Certifikatë e shtetësisë	Certifikatë e martesës	Certifikatë e vdekjes	Certifikatë e vendbanimit	Certifikatë e gjendjes martesore	Deklaratë e bashkësisë familjare	Vërtetim nga arkivi	Totali
I	Skenderaj	8995	2510	126	3202	370	1338	409	813	292	18055
	TOTALI	8995	2510	126	3202	370	1338	409	813	292	18055

2. Sektori i Administrimit me Dokumente – QSHQK/Arkivi

Gjatë vitit 2025, sektori ka kryer pranimin, regjistrimin dhe procedimin e kërkesave të qytetarëve, duke përdorur sistemet elektronike Intranet dhe SMAED për menaxhimin e dokumenteve. Janë realizuar të gjitha veprimet administrative: pranimi dhe shpërndarja e postës, skanimi, arkivimi i lëndëve dhe administrimi i vulave zyrtare.

Të dhëna kryesore për vitin 2025:

- Postë e brendshme (libri i ekspedicionit): **2,127** shkresa.
- Postë e pranuar rekomande nga PTK: **239** shkresa.
- Postë e dërguar përmes PTK-së: **435** shkresa.

Lëndë të pranura gjithsej (01.01–31.12.2025): **55,403** lëndë për Kuvendin Komunal, Kryetarin dhe të gjitha drejtoritë.

Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes 01/01/2025 - 31/12/2025

Shkurtesa	Përshkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshtë	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Përfunduar	Totali
DA	Drejtoria për Administratë	2	6	2,692	10	0	0	0	40	33,190	35,940
DA	Drejtoria për Arsim	0	1	982	412	0	257	0	18	0	1,670
DBPZHR	Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural	0	4	377	5	0	1	0	8	0	395
DEFZH	Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim	0	0	3,400	2	0	0	0	23	0	3,425
DKRS	Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport	0	6	122	11	1	2	0	8	0	150
DUNMA	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	1	25	503	0	0	70	0	18	0	617
DSHP	Drejtoria për Shërbime Publike	0	2	261	51	0	1	0	8	0	323
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	0	10	3,369	44	0	89	1	39	0	3,552
DGJKP	Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi	0	67	6,176	19	0	36	0	40	0	6,338

KK	Kuvendi i Komunës	0	5	78	0	0	0	0	5	0	88
KK	Kryetari i Komunës	0	262	1,934	20	0	48	0	45	0	2,309
DZHENIT	Drejtorja për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm	0	0	154	0	0	0	0	2	0	156
DIK	Drejtorja e Inspektoratit Komunal	0	0	214	81	0	0	0	4	0	299
DPP	Drejtorja e Prokurimit Publik	2	0	136	1	0	0	0	2	0	141
		5	388	20,398	656	1	504	1	260	33,190	55,403

3. Njësia e Transportit

Ka siguruar transport për udhëtime zyrtare, mirëmbajtje dhe servisimin e automjeteve zyrtare, evidencë të lëvizjeve, menaxhim të sistemit **GPS**, si dhe ka kontribuar në mirëmbajtjen e objekteve komunale.

4. Sektori për Integritet Evropian, DNJ dhe Barazi Gjinore (IEDNJBZ)

Gjatë vitit 2025, sektori ka realizuar aktivitete për barazi gjinore, të drejta të njeriut, fëmijëve dhe mosdiskriminim, si dhe ka raportuar obligimet nga Agjenda Evropiane. Janë shënuar data ndërkombëtare (8 Marsi, 1 Qershor, 25 Nëntori, 3 dhe 10 Dhjetori), janë organizuar fushata vetëdijësuese, ligjërata në shkollë, takime të Mekanizmit kundër Dhunës në Familje dhe bashkëpunime me institucione relevante.

5. Zyra e Teknologjisë Informative (TI)

Zyra e TI-së ka siguruar funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve Intranet, SMAED, Gjendja Civile, Tatimi në Pronë, rrjeteve dhe webfaqes zyrtare. Janë administruar email-et zyrtare, licencat softuerike, pajisjet IT, transmetimet live të seancave të Kuvendit dhe është ofruar asistencë teknike për të gjithë zyrtarët komunalë dhe njësitë vartëse.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Gjatë vitit 2025, Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka zhvilluar aktivitetet e saj në përputhje me Statutin Komunal, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, Ligjin nr. 08/L260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Ligjin për Financat Lokale, udhëzimet administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe Planin e Punës të miratuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2025.

Gjatë vitit raportues janë hartuar dhe dorëzuar me kohë në MFPT, pasqyrat financiare vjetore për vitin 2024, është përgatitur rrjedha e parasë për të gjitha programet buxhetore për vitin 2025, si dhe është bërë bartja e mjeteve të pashpenzuara nga vitet paraprake dhe destinimi i tyre për vitin 2025, bazuar në vendimet e Kuvendit Komunal. Po ashtu, ka filluar me kohë realizimi i shpenzimeve përmes sistemit FreeBalance.

Janë përgatitur raporte financiare periodike gjatë gjithë vitit 2025, të cilat janë prezantuar dhe mbështetur në Kuvendin Komunal, si dhe raporti përfundimtar për vitin 2025. Është përgatitur dhe miratuar Korniza Afatmesme Buxhetore 2026–2028, si dhe është realizuar planifikimi i buxhetit për vitet 2026–2028 në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjatë vitit është bërë barazimi i rregullt mujor i shpenzimeve me Ministrinë e Financave dhe i të hyrave, bartja e mjeteve të pashpenzuara ndërmjet tremujorëve, si dhe regjistrimi dhe verifikimi i vazhdueshëm i aseteve komunale, përfshirë formimin e komisioneve përkatëse për regjistrim, zhvlerësim dhe hedhje jashtë përdorimit të aseteve.

Në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë komunale, e veçanërisht me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, janë përfshirë në buxhetin e vitit 2025 projektet me prioritet për Komunën.

Sa i përket të hyrave vetanake, në periudhën janar–dhjetor 2025 ato janë realizuar në përputhje me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe Rregulloren Komunale për taksa, tarifa dhe gjoba, me qëllim mbulimin e shpenzimeve të planifikuara me buxhetin vjetor të miratuar nga Kuvendi Komunal. Të hyrat e realizuara janë krahasuar me vitin paraprak 2024 dhe me planifikimin buxhetor përkatës.

Pasqyra e mëposhtme prezanton të hyrat e realizuara, krahasuar më periudhën e njëjtë të vitit paraprak dhe planifikimin për vitin 2025.

Nr.	PROGRAMET /DREJTORITË	KODI	PLANI FILLESTAR 2025	REALIZIMI 2025	REALIZIMI 2024	% E REALIZIMIT	STRUKTURA E REAL. NË %
1	2		3	4	5	6	7
1	ADMINISTRATA DHE PERSONELI	16323	50,100.00	44,722.57	63,954.12	89.27	2.65
2	INSPEKTIMI	16645	9,000.00	9,530.00	8,505.00	105.89	0.57
3	BUXHET DHE FINANCA	17523	456,460.00	403,343.64	326,700.29	88.36	23.94
4	ZHVILLIMI EKONOMIK - PLANIFIKIMI	48023	55,000.00	23,700.00	28,545.00	43.09	1.41
5	SHËRBIMET PUBLIKE DHE MBROJTJA CIVILE	18023	5,500.00	2,005.00	5,368.60	36.45	0.12
6	BUIQËSI DHE ZHVILLIM RURAL	47023	13,550.00	20,099.50	12,386.80	148.34	1.19
7	GJEODEZIA, KADASTRI DHE PRONA	65315	127,923.00	106,041.91	331,503.26	82.90	6.29
8	URBANIZMI DHE MBROJTJA E AMBIENTIT	66620	631,583.00	710,798.01	694,017.11	112.54	42.19
9	SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE	73032	13,500.00	19,012.00	16,761.00	140.83	1.13
11	SHTËPIA E SHËNDETT QKMF + QPS	74400	41,300.00	32,309.50	36,823.00	78.23	1.92
12	KULTURA, RINIA E SPORTI	85023	450.00	428.00	522.00	95.11	0.03
13	ARSIMI – ÇERDHJA E FËMIJËVE	92650	55,000.00	76,173.40	52,829.00	138.50	4.52
14	TË HYRAT NGA GJOBAT NË TRAFIK DHE TË GJ.		250,100.00	236,530.00	255,880.80	94.57	14.04
	TOTAL		1,709,466.00	1,684,693.53	1,833,795.98	98.55	100.00

Bazuar në të dhënat e paraqitura, realizimi i të hyrave për vitin 2025 sipas programeve ka arritur shumën prej **1,684,693.53€**, që përfaqëson **98.55%** të planit fillestar vjetor prej 1,709,466.00€.

Të dhënat tregojnë performancë të qëndrueshme në realizimin e planit buxhetor, si dhe shpërndarje të strukturuar të realizimit ndërmjet programeve apo drejtorive përkatëse.

Punë tjera;

Është bërë, me kohë barazimi mujor dhe për periudhat e caktuara llogaritare në Departamentin e Thesarit në MF, janë bërë pjesërisht barazimet mujore me drejtoritë komunale që realizojnë të hyra dhe të njëjtën kohë janë transferuar – alokuar gjithë të hyrat e realizuara sipas pozicioneve të planifikuara buxhetore me përjashtim të hyrave që kanë tejkaluar planin 2025 dhe do të barten për shpenzim në vitin 2026.

1. Sektori i Tatimit në Pronë:

Ky sektor gjatë vitit 2025 ka punuar dhe zbatuar dispozitat Ligjore sa i përket fushëveprimtarisë së tatimit në pronë si:

- a. -Menaxhimin e informatave për pronën;
- b. -Regjistrimin dhe rianketimin e pronave;
- c. -Inkasimin e tatimit për pronën dhe
- d. -Punët tjera administrative për pronën si ankesat e obliguesve etj.

NR.	MUAJI	PLANI 2025	REALIZIMI 2025	REALIZIMI 2024	% REALIZIMIT ME PLAN ^E	KRAHASIMI 2024/2025
1	JANAR	19,000.00	11,819.76	12,791.08	62.21	4.10
2	SHKURT	25,000.00	14,462.97	6,422.43	57.85	5.01
3	MARS	20,000.00	16,588.95	7,904.72	82.94	5.75
4	PRILL	29,000.00	47,938.94	48,560.19	165.31	16.62
5	MAJ	35,000.00	43,066.83	19,536.03	123.05	14.93
6	QERSHOR	35,000.00	18,699.84	6,593.38	53.43	6.48
7	KORRIK	35,000.00	24,225.91	11,181.05	69.22	8.40
8	GUSHT	40,000.00	41,415.42	25,049.41	103.54	14.36
9	SHTATOR	30,000.00	20,632.11	16,027.20	68.77	7.15
10	TETOR	20,000.00	17,280.07	27,015.27	86.40	5.99
11	NËNTOR	26,960.00	8,226.69	12,943.98	30.51	2.85
12	DHJETOR	30,000.00	24,084.15	23,484.55	80.28	8.35
	TOTALI	344,960.00	288,441.64	217,509.29	83.62	100.00

Gjatë vitit 2025, stafi i këtij sektori është angazhuar në zbatimin e detyrave të planit vjetor, duke përfshirë mbledhjen dhe regjistrimin e pronave të reja, verifikimin e pronave të regjistruara më parë për ndryshime eventuale, inkasimin e tatimit në pronë duke përdorur format ligjore përkatëse,

si dhe azhurnimin e të dhënave në programin e tatimit në pronë. Po ashtu, janë kryer edhe punë të tjera administrative sipas kërkesave të obliguesve tatimorë dhe detyrës zyrtare.

Sa i përket Tatimit në Pronë, gjatë vitit 2025 janë realizuar të hyra në vlerë prej 288,441.64 €, që përfaqësojnë 83.62 % të planit vjetor prej 344,960.00 €. Krahasuar me vitin paraprak 2024, është shënuar rritje e realizimit të të hyrave nga ky burim.

Tabela e aktiviteteve të kryera:

	A. Anketuesit e pronave (inspektimi i pronave)	Numri i aktiviteteve
1	Anketimi i pronave të reja	438
2	Ri-anketimi i pronave ekzistuese (modifikime)	1846
3	Rajonet e anketuara, Skenderaj dhe fshatrat e Komunës	28
4	Pajisja me foto të objekteve	1050
	B. Zyra për inkasim të Tatimit në pronë	Numri i aktiviteteve
1	Kontakte me tatimpaguesit	800
2	Përgatitja e njoftimeve përfundimtare	210
3	Shpërndarja e njoftimeve të gjithë obliguesit tatimor	210
4	Marrëveshje me tatimpagues me zyrën e inkasimit	22
5	Vendime për ekzekutim të obligimeve	143
	C. Operatorët e futjes së të dhënave në sistem dhe zyrtari për ankesa	Numri i aktiviteteve
1	Vërtetime, Certifikata, Fatura etj.	4200
2	Plotësimi me numra personal për çdo tatimpagues	890
3	Evidentimi i obliguesve të mëdhenj	450
4	Kontrata shitblerjes nga D.G.J.K .	345
5	Ankesa të pranuar dhe të verifikuara në teren	50

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm (DZHENIT)

Raporti i punës së Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion e Turizëm, paraqet punën dhe aktivitetet e realizuara, përkitazi me planin e punës për vitin 2025, dokumentet strategjike si: Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal, si dokumente strategjike i cili paraqet vizionin dhe misionin e komunës.

Drejtoria gjatë viti 2025 është angazhuar në gjetjen e investitorëve dhe donatoreve potencial, të cilët kanë ofruar përkrahje për zhvillimin socio-ekonomik, përfshirë këtu: UNDP dhe Water for Life.

Ky raport paraqet në tabela për secilën njësi punët dhe aktivitetet e realizuara, duke përfshirë të dhënat e detajuara nga projektet kapitale, grantet për biznese, promovimin e turizmit dhe shërbimet për bizneset:

-Projektet Kapitale:

EMRI I PROJEKTIT	DONATORET	MUAJ/VITI	TE DHËNAT E PROJEKTIT
Projekti i ndërtimit të shëtitorës natyrale dhe krijimi i hapësirave rekreative përgjatë shtratit të lumit Klina	Komuna e Skenderajt	2024-2025	Projekti synon që ta bëjë me atraktiv për vizitorët dhe banorët qytetin e Skenderajt dhe Lumin Klina
Organizimi i panairit për gratë ndërmarrëse si dhe akterëve tjerë të rëndësishëm.	Komuna e Skenderajt	2025	Në panairin e organizuar nga DZHENIT, kanë marruar pjesë 22 pjesëmarrës, prej të cilëve 18 gra. Është bërë promovimi i prodhimeve nga veshjet tradicionale, ushqimet tradicionale, përpunimi i pemëve dhe perimeve dhe punë artizanale nga druri. Panairi është organizuar në dy faza: Faza e parë Komuna e Skenderajt që janë mbuluar

			shpenzimet e transportit dhe sigurimi i tendës nga pjesëmarrësit dhe faza e dytë është mbuluar nga AZHR në kohëzgjatje 4 ditë dhe pjesëmarrësve iu është siguruar tenda. Panairi ka pasur shumë vizitor dhe se pjesëmarrësit kanë shprehur dëshirën që të vazhdohet me organizime të tjera.
Zona Rekreative në Parkun Idriz Rreci	Komuna e Skenderajt	2025	Është punuar objekti i meremetuar për kinemanë e vogël publike, bashkë me qatinë dhe pjesa e ulëseve nga betoni për qytetaret.
Program i Qëndrueshmërisë Ekonomike me ID 010027004 në Komunën e Skenderajt	Komuna e Skenderajt UNDP	2025	Përfaqësues të DZHENIT dhe UNDP-së, fillimisht janë konsultuar për vendndodhjen e bizneseve të dëmtuara nga vërshimet dhe përcaktimi ka qenë në rrugën Ilaz Kodra. Në këtë rrugë janë vizituar bizneset dhe intervistuar, prej të cilave janë përzgjedhur 12 biznese. Me këto biznese përfaqësues të DZHENIT dhe UNDP-së, kanë bërë konsultime për përmirësimin e marketingut dhe gjithashtu sipas nevojë është intervenuar edhe me grante.
Punëtori "Promovimi i turizmit në Kosovë nëpërmjet politikave për zhvillim rajonal të balancuar"	MZHR Swiss Contact	2025	Tema : Rregullore për standardet, metodologjinë dhe sistemin e hartimit dhe monitorimit të Planeve Operacionale për zhvillim rajonal të rajoneve zhvillimore;

- Grante:

GRANTET:	DONATORI:	MUAJ/VITI	TE DHENAT E GRANTIT:
Programi për OJQ-të Lokale	Komuna e Skenderajt	Shtator, 2025	Gjatë vitit paraprak janë përkrahur 12 organizata të shoqërisë civile të cilat

sipas programit Reload			realizojnë projekte në fushën e Bizneseve, Inovacionit dhe Turizmit. Projekti ishte vazhdimësi nga viti i kaluar. DZHENIT ka vazhduar me monitorim dhe përcjelljen e pagesave.
Rregullim të furnizimit me ujë të pijes	Water for Life	2025	Riparimi i rrjetit dhe furnizimi me ujë të pijes për familje të ndryshme dhe pajisje të tjera të nevojshme, 40 familje përfituese.

-DZHENIT ka ofruar shërbime për biznese dhe qytetarë që kanë shprehur interesim për hapjen e bizneseve të reja, ndryshimin ose edhe shuarjen e tyre.

<i>Bizneset 2025</i>	<i>Hapja të reja</i>	<i>Ndryshime</i>	<i>Ndërrimi i certifikatave</i>	<i>Shuarje</i>	<i>Numri i të punësuarve të deklaruar nga bizneset e reja</i>
	172	86	48	35	235

-Bazuar në rregulloren komunale për taksa tarifa dhe gjoba, të miratuar nga asambleja komunale, DZHENIT merret edhe me taksën në biznese, shpërndarjen e tyre si dhe mbahet evidenca për këtë taksë.

-DZHENIT, gjatë vitit 2025 ka realizuar edhe një varg aktivitete:

AKTIVITETET:	MUAJ/VITI	TË DHËNAT E AKTIVITETIT:
Trajnime	Prill, 2025	Përfaqësues nga DZHENIT, kanë marrur pjesë në takimet konsultative për programin Reload 3
Monitorimi i bizneseve përfituese	Mars-Maji	Janë monitoruar 48 përfituesit e granteve nga viti 2024. Atyre iu janë marrë informatat për rrjedhën e përfitimeve respektivisht sfidave eventuale.
Vizita në biznese	2025	Janë vizituar bizneset për t'i parë nga afër, nevojat dhe kërkesat e tyre
Përgatitje e projekt propozimeve	2025	Projekt propozime janë dërguar në GIZ, UNDP dhe MZHR, për të cilat ende nuk është marrë përgjigje

Drejtoria e Prokurimit

Drejtoria e Prokurimit gjatë vitit raportues 2025 ka zhvilluar veprimtarinë e saj në përputhje të plotë me kërkesat e paraqitura nga drejtoritë kërkuuese, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme për realizimin e detyrave institucionale dhe përmbushjen e përgjegjësiave të përcaktuara për secilën drejtori komunale.

Drejtoria e Prokurimit ka përgatitur planifikimin preliminar të prokurimit, si dokument i aprovuar nga organi kompetent i Autoritetit Kontraktues në mënyrë elektronike, i cili ka qenë pjesë përbërëse e Planit të Punës së Drejtorisë së Prokurimit për vitin 2025. Të gjitha iniciimet e procedurave janë realizuar në përputhje me dispozitat e LPP-së, konkretisht nenet 33, 34, 35 dhe 36, kapitulli mbi rregullat e reklamimit dhe transparencës, brenda afateve të përcaktuara ligjore, duke siguruar konkurrencë të drejtë, shfrytëzim racional të parasë publike, efikasitet, ekonomizim, si dhe trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë.

Gjatë vitit fiskal 2025, Drejtoria e Prokurimit ka zhvilluar këto procedura të prokurimit publik:

- Procedura e hapur dhe e kufizuar;
- Procedura konkuruese me negociata;
- Procedura e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës;
- Konkursi i projektimit;
- Procedura e kuotimit të çmimeve;
- Procedura e prokurimit në vlera minimale;

Zhvillimi i procedurave përmes Platformës Elektronike të Prokurimit ka qenë funksional për të gjitha procedurat e prokurimit, duke përfshirë vlerat minimale, të vogla, të mesme dhe të mëdha. Secili proces i prokurimit (cikli i prokurimit) ka kaluar nëpër 39 faza të përcaktuara, të cilat kanë afate kohore të saktësuara për t'u realizuar në platformën elektronike.

Drejtoria e Prokurimit ka kontribuar në mënyrë aktive në zbatimin e vendimeve të Kryetarit të Komunës, duke ofruar informata dhe raporte të nevojshme për ecurinë e punës dhe procesin e vendimmarrjes. Kujdes i veçantë i është kushtuar edhe implementimit të kontratave të lidhura në vitet e kaluara, veçanërisht kontratave të punëve kapitale, të cilat pritet të përfundojnë në vitet vijuese. Pavarësisht mungesës së një zyrtari të dedikuar për menaxhimin e kontratave, në

bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa janë siguruar mjetet financiare të nevojshme për përmbushjen me sukses të obligimeve kontraktuale.

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Prokurimit ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm edhe me KRPP-në dhe Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP), duke zbatuar kontratat e prokurimit të centralizuar në përputhje me nenet 94 dhe 95 të LPP-së.

Në vijim të raportit paraqiten në mënyrë të detajuar objektivat e drejtorive komunale dhe aktivitetet e realizuara nga Drejtoria e Prokurimit gjatë vitit fiskal 2025, sipas kategorive: punë, shërbime dhe furnizime, për përmbushjen e kërkesave të të gjitha njësive shpenzuese të Autoritetit Kontraktues.

KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE VITI FISKAL 2025

NR. RENDOR	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT TË PROKURIMIT
01.	002 - Furnizim me material shpenzues për laborator për QKMF Skenderaj
02.	003 - Furnizim me barna dhe material shpenzues për QKMF - Skenderaj
03.	073 - Mirëmbajtja dhe servisimi i nxemjeve në të gjitha shkollat dhe institucionet tjera vartëse të Drejtorisë së Arsimit- Skenderaj
04.	075 - Shërbimet e kujdesit social, shëndetësor, shtëpiak dhe ambulatorë në QKMF-Skenderaj
05.	005 - Furnizim me një kompjuter për nevojat e Drejtorisë së Arsimit - Ritender
06.	012 - Furnizim me pajisje të IT-së
07.	010 - Furnizim me toner për fotokopje
08.	048 - Sigurimi i Automjeteve Zyrtare në institucionet e Komunës së Skenderajt
09.	020 - Furnizim me dy kompjuter
10.	004-Qyteti i mençur-Smart City për Komunën e Skenderajt-Ritender
11.	019-eliminimi (largimi)e Deponive të egra me mbeturina të Amvisërisë dhe Inerte

12.	017 - Furnizim dhe mbjellje e luleve - drunjeve në hapësirat gjelbëruese të qytetit - ritender
13.	011- Kyqjet individuale në rrjetin e ujësjellësit në fshatin Burojë - faza 2
14.	016 - Furnizim dhe mirëmbajtja e kamerave të hapësirave
15.	001 - Ndërtimi i qendrës kulturore në Skenderaj dhe ndërtimi i muzeut dhe bibliotekës së qytetit
16.	023 - Riparimi dhe rregullimi i parkut "Idriz Rreci" dhe "Shaban Polluzha"
17.	009 - Furnizim me paisje elektronike për nxënësit e dalluar në gara komunale, regjionale dhe në gara republikane.
18.	024 - Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në qytet, rruga Ali Gashi , rruga 28 Nëntori dhe rruga Fehmi dhe Xhevë Lladrovci
19.	007 - Mirëmbajtja dhe servisimi për ngrohje, ftohje, ventilim dhe klimatizim në Objektin e Komunës, Shtëpinë e Kulturës, Palestrën Sportive, QKMF-së, AMF-të në bashkësi lokale, SHPMPF dhe objekti i QPS-së në Skenderaj.
20.	027 - Kyqja në rrjetin elektrik të Institucionit Parashkollor Çerdhja e re në komunën e Skenderajt
21.	035 - Organizimi i panairit për gratë ndërmarrëse si dhe akterëve tjerë të rëndësishëm.
22.	044- Furnizimi me material shpenzues për QKMF-në në Skenderaj
23.	006-Furnizimi me barna dhe material shpenzues për QKMF në Skenderaj
24.	036 - Furnizimi dhe montimi i rrjetit të energjisë elektike për Tregun e Gjelbërt
25.	032 - Kontrollimi teknik i automjeteve zyrtare në institucionet e Komunës së Skenderajt-Ritender
26.	030-Furnizimi me material shpenzues për laboror për QKMF-në në Skenderaj
27.	032-Mirëmbajtja dhe servisimi i ashensorëve në objektin e komunës së Skenderajt dhe objektin e QKMF-së
28.	044 - Pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në territorin e komunës së Skenderajt gjatë sezonit dimëror

29.	037 - Furnizim dhe vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale të komunikacionit në Komunën e Skenderajt
30.	014 - Rrënimi i objekteve të vjetra dhe objekteve pa leje në Komunën e Skenderajt
31.	045 - Furnizimi dhe montimi i dyerve sensorike automatike dy krahëshe
32.	046 - Furnizimi me një kompjuter për nevojat e Drejtorisë së Bujqësisë në Skenderaj
33.	029 - Furnizim me dron dhe paisje përcjellëse
34.	031 - Rregullimi i subqendrës - Klinikë e Epërme - Skenderaj
35.	048 - Ndërtimi i zonave rekreative në Skenderaj, parku Idriz Rreci
36.	047 - Furnizim me lodra për fëmijët e IP Çerdhja e Re në Skenderaj
37.	040 - Furnizim me ushqim dhe pije si dhe me material higjieniko - sanitar për nevojat e shkollave si dhe të gjitha institucioneve tjera në kuadër të komunës së Skenderajt
38.	042 - Pastrimi i hapsirave të brendshme dhe të jashtme të IP Çerdhja e Re në Skenderaj.
39.	Furnizimi me material shpenzues për QKMF-ne -Skenderaj
40.	Furnizim me pajisje të IT-së
41.	043 - Furnizim me mekanizëm bujqësor
42.	050 - Pastrimi i automjeteve zyrtare, vullkanizimi, balancimi, montimi dhe demontimi i gomave në komunën e Skenderajt
43.	008 - Furnizim me tableta për nxënësit e dalluar në gara komunale, regjionale dhe në gara republikane
44.	026 - Furnizim me barna dhe material shpenzues për QKMF-në - Ritender

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

Gjatë vitit 2025, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka realizuar një sërë aktivitete në funksion të zhvillimit të sektorit bujqësor dhe mbështetjes së fermerëve në të gjithë territorin e Komunës së Skenderajt.

1. Aktivitetet kryesore të drejtorisë:

- Është realizuar monitorimi i mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore në të gjithë territorin e komunës.
- Është ofruar informim dhe asistencë e vazhdueshme për fermerët lidhur me grantet dhe skemat mbështetëse të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR).
- Është realizuar ndarja e granteve komunale për fermerët e Komunës së Skenderajt për vitin 2025.
- Është zhvilluar bashkëpunim i vazhdueshëm me donatorë vendorë dhe ndërkombëtarë në funksion të mbështetjes së sektorit bujqësor.

2. MBËSHTETJA PËRMES GRANTEVE KOMUNALE

Në kuadër të granteve komunale, janë shpërndarë pajisje dhe mjete bujqësore si më poshtë:

Pajisje dhe mjete bujqësore:

- 16 freza
- 16 grabuja diellore
- 16 rrota kosa
- 16 spërkatëse
- 2 mbjellëse të qepëve
- 2 mbjellëse të patateve

Mbështetje në pemëtari:

- 22 përfitues me pemë të përziera
- Sipërfaqe totale e mbjellë: **16.15 ha**

3. Bashkëpunimi me donator:

3.1 Bashkëpunimi me Islamic Relief Kosova (IRK)

Në bashkëpunim me organizatën **Islamic Relief Kosova (IRK)** janë mbështetur gjithsej **316 familje**, përmes pajisjeve dhe investimeve si në vijim:

- 12 pijatore (24 disqe)
- 23 mbjellëse misri
- 24 mbjellëse gruri
- 65 sera (100 m²)
- 10 puse për ujë të pijshëm
- 3 mbjellëse patatesh
- 23 spërkatëse
- 103 freza (1.65 m)
- 10 plugje dy-rendorë
- 40 shpërndarëse plehu (500 L)
- 3 atomizer

3.2 Bashkëpunimi me IADK:

Në bashkëpunim me **Iniciativën për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK)** janë mbështetur gjithsej **15 familje**, përmes:

- 10 mjeteve për bletari
- 2 pika përpunuese për pemë dhe perime
- 3 laktofriza

3.3 Bashkëpunimi me FAO

Në bashkëpunim me **FAO**, janë mbështetur gjithsej **31 familje**.

3.4 Bashkëpunimi me Qatar Charity Kosova

Në bashkëpunim me **Qatar Charity Kosova**, janë mbështetur gjithsej **12 familje**, përmes:

- 1 familje me 5 shoqëri bletësh
- 9 motokultivatorë me frezë dhe kosë
- 2 motokultivatorë me frezë, kosë dhe rimorkio

4. Aktivitetet tjera te rëndësishme:

- Aplikime për subvencione nga **1,772 fermerë** për sipërfaqe të mbjella.
- Subvencionim i grurit për **910 fermerë**.
- Dy thirrje për subvencione për qumësht dhe majmëri, me mbi **126 fermerë aplikues**.
- Marrëveshje me fondacionin "**StrayCoCo**", ku janë trajtuar rreth **80 qen endacakë** (kastrim/sterilizim).
- Monitorim i menaxhimit të vendgjuetive dhe hapja e sezonit të gjuetisë.
- Monitorim i procesit të kortje-shirjeve në të gjithë territorin e komunës.

5. TRAJNIME DHE NGRITJE E KAPACITETEVE

Gjatë vitit 2025 janë organizuar trajnime dhe aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të fermerëve, si:

- Kultivimi dhe mirëmbajtja e pemëve frutore.
- Varietetet dhe kultivimi i grurit.
- Kultivimi i perimeve në serë dhe në fushë të hapur.
- Prodhimi higjienik i qumështit.

Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural gjatë vitit 2025 ka realizuar me sukses aktivitetet e planifikuara, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të prodhimit bujqësor, rritjen e kapaciteteve të fermerëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm rural në Komunën e Skenderajt.

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, gjatë vitit **2025**, ka realizuar shumicën e objektivave të parapara, me prioritet shqyrtimin e **lëndëve të mbetura nga viti paraprak** dhe trajtimin e kërkesave brenda afateve ligjore. Është avancuar bashkëpunimi me sektorët komunalë dhe institucionet qendrore, ndërsa reformat ligjore të MMPHI-së dhe AKK-së kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e efikasitetit.

Drejtoria përbëhet nga **tre sektorë**, të cilët ofrojnë shërbime të ndërlidhura pronësore dhe kadastrale, përfshirë: ndryshimin e pronësisë, regjistrimin e hipotekave, ndarjen/bashkimin e parcelave dhe ndërtesave, pajisjen me certifikata pronësie, si dhe shërbime të tjera kadastrale.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar aktivitete administrative dhe në terren, bashkëpunim ndërinstitutional, shërbime për qytetarë, si dhe mbështetje për drejtoritë komunale dhe Inspektoriatin. Pavarësisht kapaciteteve të kufizuara njerëzore, drejtoria ka shfrytëzuar maksimalisht resurset për të ofruar **shërbime efikase dhe cilësore** për qytetarët e Komunës së Skenderajt.

Gjatë vitit **2025**, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka kryer aktivitete brenda kompetencave të saj, duke përfshirë:

- Takime zyrtare me institucionet qendrore dhe bashkëpunim me sektorët komunalë.
- Aktivitet në terren për shërbime ndaj qytetarëve dhe mbështetje të projekteve komunale.
- Pajisje me certifikata pronësie, kopje plani dhe shërbime të tjera kadastrale.
- Shqyrtim, aprovimin/refuzimin e kërkesave dhe ofrim të sqarimeve juridike-pronësore.
- Mbështetje ndaj Inspektoriatit dhe Drejtorisë së Urbanizmit për verifikime, matje dhe identifikim të gjendjes faktike.
- Zbatim të rekomandimeve nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Pavarësisht numrit të kufizuar të punëtorëve, drejtoria ka shfrytëzuar maksimalisht kapacitetet për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve pronësore dhe kadastrale për qytetarët e Skenderajt.

Kërkesat	Të pranuara	Të miratuara	Të refuzuara	Në proces	Gjithsej
Certifikata të Paluajtshmërisë	2856	2856	0	0	2856
Kopje të Planit	961	960	1	0	961
Bartje e Pronësisë apo Posedimit	1032	1024	8	0	1032
Modifikim i parcelave	124	120	4	0	124
Bashkim i parcelave	63	62	1	0	63
Ndarje e Parcelave	142	134	8	0	142
Regjistrim i ndërtesave	30	29	1	0	30
Regjistrim i pjesëve të ndërtesave	29	29	0	0	29
Regjistrim/ qiramarrja	38	35	3	0	38
Regjistrim i ngarkesës tatimore	4	4	0	0	4
Fshirje e ngarkesës tatimore sipas vendimit të ATK-së	3	3	0	0	3
Bashkim i personave të njëjtë me ID të ndryshme në RDPP	15	15	0	0	15
Regjistrim, Modifikim dhe Fshirje e Hipotekave	77	75	2	0	77
Modifikim i të dhënave të personave në RDPP	56	55	1	0	56
Vërtetim që nuk posedon pronë	31	31	0	0	31
Kërkesa për shfrytëzim të pronës komunale (parkingje)	33	13	0	20	33
Kërkesa për heqje dorë nga pronësia	1	1	0	0	1
Të tjera					
TOTAL					5495

1. Sektori për Gjeodezi dhe Kadastër

UNIREF	Dokumenti	Shuma
SKG4L	Regjistrim, Modifikim, Bartje e Pronësisë apo Posedimit	35,798 €
SKG4M	Taksë - Ndërrim i destinimit të tokës	1435 €
SKGFP	Taksë për fletë poseduese dhe kopje të planit	9257 €

SKG4U	Taksë administrative	4295 €
SKG9D	Aktivitete në teren	26,338 €
Totali i të hyrave në këtë sektor:		77,123 €

2. Sektorit i Pronës

UNIREF	Dokumenti	Shuma
SKG8E	Rente - Shfrytëzimi i pronës publike	11,819.05 €
SKG8H	Qiraja nga objektet publike	17,099.36 €
Totali i të hyrave në këtë sektor:		28,918.41 €

Totali i të hyrave në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë për periudhën **Janar 2025 – Dhjetor 2025** është: **106,041.41 EURO**

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit

Drejtoria për Urbanizëm, gjatë vitit 2025, ka kryer me kohë dhe brenda afateve ligjore të gjitha punët administrative, pa vonesa apo ngecje, pavarësisht kompleksitetit të lëndëve. Janë trajtuar lëndë që lidhen me leje ndërtimore, legalizim, kërkesa të qytetarëve për projekte infrastrukturore, si dhe lëshim vërtetimesh e certifikatash. Po ashtu, Drejtoria ka përgatitur projekt-propozime, ka menaxhuar dhe mbikëqyrur projekte, si dhe ka realizuar pranimet teknike.

Realizmi i projekteve gjatë vitit 2025:

- Hartimi i projekteve teknike - (vazhdim)
- Punimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kyqeve në Burojë - (vazhdim)
- Trotualet dhe ndriçimi në BL Likovc, Klinë e Epërme, Polac, Runik, Turiqevc - (vazhdim)
- Unaza e brendshme 3 krahë kah Llausha - (vazhdim)
- Kanalizimi Syriganë, Banjë – Pemishtë - (vazhdim)
- Asfaltimi i rrugës në Lagjen 3 – Prekaz - (ka përfunduar)
- Punimi i rrjetit të ujësjellësit në BL Qirez - (vazhdim)
- Ndërtimi i Rrugës Kozhicë- Qyqavicë - (ka përfunduar)

- Ndërtimi i Rugës Syriganë-Bjeshka e Syriganës - (ka përfunduar)
- Rregullimi i subqendrës –Likovc - (vazhdim)
- Rregullimi i subqendrës –Runik - (vazhdim)
- Rregullimi i subqendrës – Qirez - (vazhdim)
- Tribunat në stadiumin të qytetit - (vazhdim)
- Kanalizimi Klinë - Kuqicë - (vazhdim)
- Kanalizimi Aqarevë dhe Kopiliq i ulët dhe në BL, Runik, Prekaz, Turiquevc, Qirez, Rezallë, Klinë e Epërme, Polac dhe qytet - (vazhdim)
- Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Kuqicë, Qubrel, Kosterc, Vitak, Klladernicë, Burojë, Vajnik, Abri, Ticë, Klinë, Prekaz, Mikushnicë, Polac, Makermal, Rakinicë, Llaushë - (vazhdim)
- Ndërtimi i urave në fshatrat Aqarevë, Llaushë, Kuqicë, Terrnavc, Tushilë, Kllodenicë - (vazhdim)
- Asfaltimi i rrugës nga lagja Zabeli deri të shkolla Malush Ahmeti si dhe rrugët lidhëse faza 2 -Rezallë e re - (vazhdim)
- Poligoni sportiv të shkolla Ahmet Delia - (vazhdim)
- Ndërtimi i çerdhes për fëmijë-vazhdimi i aneksit dytë - (vazhdim)
- Kanalizimi fekal Izbicë - Rakinicë dhe Leqinë - (vazhdim)
- Asfaltimi, riparimi dhe kubëzimi i rrugëve në qytet dhe BL Likovc, Turiquevc, Runik, Qirez - (vazhdim)
- Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Klinë, Polac, Makermal, Ticë, Kopiliq i Epërm, Rakinicë - (vazhdim)
- Ndërtimi i muzeut dhe bibliotekës së qytetit - (vazhdim)
- Rregullimi i shtatit të lumit Klinë e ulët-Kuqicë dhe dy degëzimet e Llaushës- (vazhdim)
- Ndërtimi i shëtitorës natyrale dhe krijimi i hapësirave rekreative përgjatë shtratit të lumit Klina - (vazhdim)
- Riparimi dhe rregullimi i parkut "Idriz Rreci" dhe "Shaban Polluzha"- (vazhdim)
- Riparimi dhe asfaltimi i rrugëve në qytet - (vazhdim)
- Rregullimi i subqendrës - Klinë e Epërme - (vazhdim)
- Kycja e kanalizimit lagja Kodra-Polac - (vazhdim)

Raporti i lendeve për vitin 2025:

Nr	Llojet e aplikimeve	Shuma €
1	Numri i lejeve të ndërtimit të lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit	25
2	Numri i lejeve mjedisore	15
3	Kërkesat për legalizim	57
4	Të tjera	410
	Totali i të gjitha kërkesave	507

Të hyrat nga DUMA për vitin 2025:

Nr	Llojet e aplikimeve	Shuma €
1	Të hyrat nga leje Ndërtimore	390,577.68
2	Të hyrat nga leje Mjedisore	34,514.52
3	Të hyrat nga legalizimi	3,886.81
4	Të hyra nga koncesioni	280,000.00
	Totali i të gjitha kërkesave	708,979.01

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport

Gjatë vitit 2025, Sektori për Kulturë, Rini dhe Sport ka zhvilluar një sërë aktivitete kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë:

- Thirrje publike për projekte dhe programe;
- Homazhe dhe manifestime për ditë historike dhe përkujtime;
- Organizim festivalesh, turne sportivë dhe aktivitete edukative;
- Menaxhimi i muzeut dhe arkivit historik;
- Aktivitetet rinore dhe trajnime për të rinjtë.

Ngjarje dhe aktivitet kryesore:

Janar – Mars:

- 10 Janar: Thirrja publike për projekte në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- 17 Shkurt: Homazhe për Ditën e Pavarësisë së Kosovës në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” dhe Morinë; turnirë basketbolli dhe gara sportive.
- 24 Shkurt: Publikimi i listës së fituesve të subvencionëve, gjithsej 27 aplikantë të shpërndarë në tri fusha: sport, kulturë dhe rini.
- 28 Shkurt: Homazhe për 27-vjetorin e Betejës së Qirezit dhe Likoshanit.
- 5-7 Mars: Shënimi i 26-vjetorit të Epopesë së UÇK-së me aktivitete kulturore dhe sportive, koncert “Nata e Zjarreve”, paradë me automjete off-road, homazhe dhe seanca solemne.

Mars – Prill:

- 18 Mars: Ceremonia e përcjelljes së babait të presidentit Hashim Thaçi.
- 24 Mars: Maratona “Vrapimi i Marsit” – Izbicë.
- 26 Mars: Avancimet Kulturore “Prof. Ajet Beqiri” – pjesëmarrje e nxënësve në letërsi dhe art figurativ, shpërndarja e çmimeve.
- 28 Mars: Tubim përkujtimor për Masakrën e Izbicës, pjesëmarrje rreth 850-1000 qytetarë.
- 5 Prill: Përkujtohet masakra e Rezallës.
- 30 Prill: Përkujtohet Komandanti Ilaz Kodra dhe 40 dëshmorët e Drenicës; turneu memorial në futboll.

Maj – Qershor:

- 13 Maj: Homazhe për dëshmorët Tahir dhe Nebih Mehes në Prekaz.
- 4 Qershor: Festival Teatrot Shkollore “Drenushat” – edicioni i 18-të, pjesëmarrje mbi 100 nxënës.

- 18 Qershor: Dita e Çlirimit të Skenderajt – homazhe në Prekaz dhe Morinë, akademi përkujtimore, shpallje qytetar nderi.
- Qershor – Korrik: Vizita në Muzeun e qytetit, aktivitete edukative dhe ekspozita fotografike nga nxënësit.

Korrik – Tetor:

- 20 Korrik – 14 Gusht: “Muaji i Diasporës” – aktivitete muzikore dhe kulturore për qytetarët dhe diasporën, pjesëmarrje mbi 100,000 qytetarë.
- Shtator: Vizita të shumta në shkolla dhe muze.
- 3 Tetor: Shfaqja “Magjia e Leximit” në bashkëpunim me UNICEF.
- 7 Tetor: Thirrje publike për Festivalin Gjithëkombëtar “Rapsodia Shqiptare” – edicioni i 20-të.

Nëntor – Dhjetor:

- 6 Nëntor: Publikimi i listës për festivalin “Rapsodia Shqiptare”.
- 25 Nëntor: Shfaqje artistike nga Ansambli “Nënë Terezë” – Tiranë.
- 26-28 Nëntor: Festival Folklorik “Rapsodia Shqiptare”, pjesëmarrje mbi 1000 shikues, shpërndarja e çmimeve.
- 28 Nëntor: Ceremonitë e zbulimit të busteve dhe obeliskeve për heroin Hamëz Jashari dhe bashkëpunim me Qendrën e Kulturës.
- 10 Dhjetor: Ndezja e dritave të fund vitit në komunë.
- 30 Dhjetor: Darka e fund vitit me punëtorët e administratës komunale.
- 31 Dhjetor: Festimi i Vitit të Ri në Sheshin “Adem Jashari”.

Aktivitetet tjera:

Muzeu: Vizita nga shkolla dhe qytetarë nga mërgata dhe niveli lokal.

Arkiva: Ruajtja, evidentimi, digjitalizimi dhe shërbimi ndaj qytetarëve dhe institucioneve.

Rinia: Organizim trajnimesh dhe workshopesh për leadership, aktivizëm rinor, vullnetarizëm, aktivitete edukative dhe kulturore, bashkëpunim me OJQ lokale.

Drejtoria për Shërbime Publike

Raporti Vjetor 2025 i Drejtorisë për Shërbime Publike paraqet në mënyrë të strukturuar, të gjitha aktivitetet, angazhimet dhe rezultatet e arritura gjatë vitit kalendarik 2025.

Gjatë këtij viti, drejtoria ka qenë e angazhuar në mirëmbajtjen e infrastrukturës publike, ndriçimit publik, rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit, menaxhimin e mbeturinave, si dhe në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit. Fokus i veçantë i është kushtuar reagimit të shpejtë ndaj kërkesave të qytetarëve dhe respektimit të afateve ligjore.

1. Sektori për Shërbime Publike

Sektori për Shërbime Publike gjatë vitit 2025 ka zhvilluar aktivitete të vazhdueshme në përputhje me rregulloren e punës dhe kompetencat e përcaktuara. Janë shqyrtuar kërkesa të shumta të qytetarëve dhe janë realizuar ndërhyrje në terren në koordinim me operatorët ekonomikë kontraktues.

Aktivitetet kryesore kanë përfshirë:

- mirëmbajtjen e ndriçimit publik;
- deblokimin dhe sanimin e rrjetit të kanalizimit;
- shtrirjen e rrjeteve të reja, si dhe monitorimin e punimeve nga zyrtarët përkatës.

2. Menaxhimi administrative dhe ligjor

Gjatë vitit 2025 janë proceduar gjithsej 311 lëndë administrative. Prej tyre, 246 janë aprovuar, 52 janë refuzuar, ndërsa pjesa tjetër është trajtuar sipas procedurave ligjore në fuqi. Të gjitha lëndët janë trajtuar brenda afateve ligjore.

3. Menaxhimi financiar dhe kontratat

Gjatë vitit 2025 janë menaxhuar kontrata të ndryshme për mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit, ndriçimit publik dhe shërbimeve tjera komunale.

Tabela e raportit nga Ujësjiellësi:

Kompania e Ujësjiellësit - Njësia në Skenderaj									
Raporti i rrjedhjeve dhe deblokomi I kanalizimeve Dt:01.01.2025-31.12.2025									
Kërkesat		Kërkesat e realizuara ujësjiellës	Kërkesat e realizuara te Kanalizimeve		Kërkesat e ardhura nga komuna për sanim te rrjedhjeve			Kërkesat e ardhura nga komuna për de bllokim te Kanalizimeve	
Nr.	Muajt	E sanuar	I Debllokuar		E sanuar			I Debllokuar	
		Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo
1	Janar	12		2					
2	Shkurt	16		2		1		1	
3	Mars	21		2		1			1
4	Prill	15		3					
5	Maj	15		3				1	
6	Qershor	15		3		1		1	
7	Korrik	13		3					1
8	Gusht	16		2				1	
9	Shtator	24		3				1	
10	Tetor	20		3					
11	Nëntor	17		3		1			
12	Dhjetor	20		4					1
Totali		204	0	33	0	4	0	5	3

Operatori Ekonomik: DESHISHKU GB-SHPK				
Titulli i kontratës : Mirëmbajtja e rrjetit te kanalizimit brenda territorit të Komunës së Skenderajt				
RAPORTI I PUNIMEVE SI MBAS FATUEAVE ME SITUACIONE				
	Data e faturimit	Numri i faturës	VLERA E FATURAVE	PAGESAT
SITUACIONET ME FATURA PER VITIN 2024				
Situacioni i -I-		1.2024	7860.92	E paguar

Situaciono i -II-		2.2024	4959.4	E paguar
Situacioni i -III-		3.2024	19992.58	E paguar
Situacioni i -IV-		4.2024	15198.77	E paguar
Situacioni i -V-		6.2024	20218.34	E paguar
Totali i faturave për vitin 2024				68230.01
SITUACIONET ME FATURA PER VITIN 2025				
Situacioni i -VI-			20708.87	E paguar
Situacioni i -VII-			19848.36	e paguar
Situacioni i -VIII-			9589.23	JO e paguar
Situacioni i -IX-			21591.81	JO e paguar
Situacioni i -X-			39303.49	JO e paguar
Situacioni i XI-			728.23	JO e paguar
Totali i faturave për vitin 2025				111769.99
TOTALI I PUNIMEVE TE PUNUARA			180000.00	
BUXHETI I PA SHPENZUAR			0.00	
TOTALI FATURAVE TE PA PAGUARA PER V. 2025				71212.76

4. Menaxhimi i mbeturinave

Gjatë vitit 2025 janë identifikuar dhe trajtuar 126 deponi ilegale në territorin e Komunës së Skenderajt. Aktivitetet janë realizuar në bashkëpunim me operatorët përkatës dhe institucionet relevante.

Nr. i deponive të trajtuara në fshatra e Komunës së Skenderaj gjatë vitit 2025

Nr.	Lokacioni i Deponive	E Vogël	E Mesme	E Madhe	Makro-Deponi	Totali
1	Skenderaj	7	3	2	1	13
2	Klinë e Epërme	1	2	1	1	5
3	Klinë e Mesme	2	1	1		4
4	Klinë e Poshtme	1	2	1		4
5	Ternave		1			2
6	Kuqicë		2	1		3
7	Prekaz i Epërme		2	1		3
8	Prekaz i Poshtme		3	1		4

9	Polac		2	2	1	5
10	Kryshec		2	1	1	4
11	Llaushë		2	1	1	4
12	Morinë	1	1			2
13	Makerrmal	1	2	2		5
14	Rezallë		1	1	1	3
15	Likoc	2	1	1		4
16	Ticë			1	1	2
17	Plluzhinë		1	1		2
18	Abri e Poshtme		1	2	1	4
19	Dashec		1		1	2
20	Baks		1			1
21	Qirez		2	1	1	4
22	Kozhicë	2	1			3
23	Krasaliq		1	1		2
24	Prellloc	1	1			3
25	Krasmirovce		1			1
26	Çubrel		1			1
27	Vitak		1	1		2
28	Runik		2	1		3
29	Kosterre					
30	Pemishte					
31	Syriganë					
32	Radishevë			1		1
33	Bajë					
34	Leqinë		1	1		2
35	Çitak		1			1
